



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
VU644 – 25 – 6198 – 1-2-1/C1065
14 Nr. 916/25
Dt. 25.08.2025

KONTRATË FURNIZIMI

Palët kontraktuese :

1. Komuna e Vushtrrisë, si autoritet kontraktues, të cilën e përfaqëson: – **Ilmi Azemi – Drejtor i Drejtorisë për Prokurim Publik** (në tekstin e mëtejshëm **PORORSITËSI**), dhe
2. “ Srahep “sh.p.k. emri i biznesit/ “ Srahep “emri tregtar, me seli në **Prishtinë, me ARBK: 812010338, si Operatorë Ekonomik, të cilën e përfaqëson z. Ardian Morina, në tekstin e mëtejshëm KONTRAKTUESI - FURNIZUESI**

, janë pajtuar të lidhin këtë kontratë publike, për furnizime , si vijon: **Furnizimi me inventar për shkolla, me numër identifikues:**

Nr. i prokurimit	VU644	2	5	61	9	8	1	2	1
Nr. i brendshëm	VU644	2	5	0	4	1	1	2	1

Neni 1 Lënda

- 1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i furnizimeve dhe shërbimeve nga ana e Kontraktuesit, si vijon : **Furnizimi me inventar për shkolla, në pajtim me Përshkrimin Teknik dhe Specifikat Teknike dhe përshkrimin teknik të ofertës me nr. Referues : VU644-25-6197-121 , nr. i brendshëm i prokurimit: VU644-25-041-121**

Neni 2 Kushtet e dërgesës

- 2.1 Afati kohor për dorëzimin e mallit është : 20 (njëzet) ditë kalendarike nga data e lëshimit të Urdhërblerjes, respektivisht dërgimit të Fletporosisë nga A.K.
- 2.2 Mbikëqyrja e cilësisë dhe sasisë së liferimit të mallit , do të bëhet nga Menaxheri i Kontratës dhe Mbikëqyrësi i Menaxherit të Kontratës i Autoritetit Kontraktues, i emëruar nga ana e Zyrtarit Kryesor Administrativ të Autoritetit Kontraktues. Asnjë furnizim i mallit respektivisht asnjë ekzekutim i shërbimeve nuk do të konsiderohet valid dhe i pranuar, deri sa nuk konfirmohet cilësia dhe sasia, nga ana e Menaxherit të Kontratës, Mbikëqyrësit të Menaxherit të Kontratës.
- 2.3 Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP¹ (Dërgesat e Detyrës të Paguara).
- 2.4 Kontraktuesi, para nënshkrimit të kontratës, do të dorëzoi tek A.K. Sigurimin e ekzekutimit të kontratës 10% (dhjet përqind) e vlerës së përgjithshme të kontratës. Dokumenti-Polisa e sigurimit apo dokument bankar me afat validiteti për perjudhen kohore prej 50 ditësh nga data e specifikuar për lidhjen e kontratës.
- 2.5 Garancioni për cilësinë dhe përshtatshmërinë e mallrave do të jetë përgjegjësi e Furnizuesit. Furnizuesi do të ofroi garanci për pjesët mekanike, elektrike dhe pajisje elektronike , minimum 12 muaj, bazuar në Deklaratën me shkrim të Kontraktuesit - Furnitorit .

¹⁷ DDP – Dërgesat e Detyrës të Paguara –Incoterms 2010 Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

Neni 3 Çmimi

- 3.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: 21,510.00€ (njëzetënjëmijëpesqindëdhjetë/00€).
- 3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër është i prerë, nuk do të nënshtrohet ndryshimeve dhe, është e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit / Kryesit të shërbimeve, sipas Kontratës.
- 3.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës, respektivisht sipas Raportit të prezantuar – dorëzuar nga Menaxheri i Kontratës I Autoritetit Kontraktues.

Neni 4 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e përgjithshme dhe të Veçanta të kontratës
- (c) Aneksi 1. Specifikimet Teknike të Detyrueshme
- (c) PJESA B: Draft kontrata
- (d) Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);
- (e) Plani për menaxhimin e kontratës;

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënie e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe² në katër origjinale, tri prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues: Komuna
Vushtrri

Për Kontraktuesin : " Srahep"sh.p.k.--
Prishtinë

Emri:	Ilmi Azemi	Emri:	Ardian Morina
Pozita:	Drejtor	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	25.08.2025	Data:	25.08.2025
Vula:		Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

Numri i prokurimit: VU644-25-6186-1-2-1 apo nr. i brendshem: VU644-25-041-121Thulli: Furnizim me inventar për shkollë

Shënimi: Te përshkrimi i çmimeve duhet plotësuar vetëm kolonat F dhe G. Në kolonën F ju duhet të plotësoni deke shkruar normën e TVSH-së, vetëm si numër 0, 8, apo 18, e jo në formën 0%, 8% apo 18%. Në kolonën G, duhet të plotësoni me qmimin për njësi me TVSH, po ashtu qmimin duhet ta shkruani me dy numra pas presëzës dhjetore

Nr.	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi për njësi pa TVSH	Norma e TVSH-së në %	Çmimi për njësi (me TVSH)-€	Totali (pa TVSH)	TVSH	Totali (me TVSH)-€
1	Furnizimi, transporti dhe shpërndarja në klasë të inventarit, - banaka me dy ulëse shkollore per cikelin e ulët nga	Copë	256.00	25.42	18.00	30.00	6508.47	1171.53	7680.00
2	Furnizimi, transporti dhe shpërndarja karrikave për nxënës të çelësi të ulët 1-5 klasë me standard të arsimit	Copë	512.00	12.71	18.00	15.00	6508.47	1171.53	7680.00
3	Furnizimi, transporti dhe shpërndarja e banakave individuale për fëmijët parashkollorë sipas standardeve	Copë	30.00	25.42	18.00	30.00	762.71	137.29	900.00
4	Furnizimi, transport dhe shpërndarja e karrikave për cikelin parashkollorë	Copë	130.00	12.71	18.00	15.00	1652.54	297.46	1950.00
5	Furnizimi, transporti dhe montimi i tabelave të murit	copë	20.00	55.08	18.00	65.00	1101.69	198.31	1300.00
6	Furnizimi, transporti dhe shpërndarja e tavolinave me dollapa për mësimdhënës	Copë	20.00	42.37	18.00	50.00	847.46	152.54	1000.00
7	Furnizimi, transport dhe shpërndarja e karrikave për mësimdhënës	copë	20.00	42.37	18.00	50.00	847.46	152.54	1000.00
TOTALI I PËRCJFTSHËM ME TVSH							18,228.81	3,281.19	21,510.00

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)

EMRI I OE:	SRAHEP SH.P.K
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFQESUESIT TË OE:	ARDIAN MOJIBEGJESI TE KALIBARA
MËNSHKRIMI:	
DATA:	30-07-2015
VULA:	